



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Primitjen/Prodoto Received/Delivety	12	12	2	viti god year
Organ/Njësia Org./Jedinica Org./Unit	SKPM/SHCK	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	7947	2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.954/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.954/2022 të datës 27.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa më numër A.nr.954/2022 e datës 27.10.2022 e parashtruar nga ankuesja si e bazuar.
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejte" e shqiptuar ndaj ankuseses përmes shkresës (aktit) me shenjen Ref:263/2022 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësës civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Zyrën e Kryeministrit, më datë 27.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6493/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër





masës disiplinore "Vërejte" e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm përmes aktit më shenjë Ref:263/2022 të datës 04.10.2022, me pretendimet së masa e kundërshtuar me ankesë është e pa bazë dhe tendencioze dhe së me shqiptimin e saj ankuesja është dëmtuar profesionalisht dhe personalisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Zyrën e Kryeministrit, ndërsa kjo e fundit më datë 08.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen në vendosje.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 6493/2022 të datës 27.10.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref: 212/2022 të datës 02.09.2022; Vendimin më numër Ref: 179/2022 të datës 25.07.2022; Raport me numër protokoll 1613/5 i datës 30.08.2022; Procesverbal i takimit të Komisionit për zgjedhjes e dy përfaqësuesve nga grupi i ekspertëve të jashtëm i datës 29.08.2022; Formulari 8 për vlerësimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit vlerësues për ekspert të jashtëm nënshkruar nga ankuesja; Emailin e datës 06.09.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 02.09.2022 nga Emailin e datës 06.09.2022 na për ankuesen; Emailin e datës 07.09.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 21.09.2022 nga për Emailin e datës 22.09.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 03.10.2022 nga për dhe ankuesen; Vendimin me numër Ref: 258/2022 i datës 04.10.2022; Masën disiplinore "Vërejtje" me numër Ref:263/2022 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 6897/2022 e datës 08.11.2022; Akt Emërimit e ankueses i datës 14.02.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa i datës 25.02.2019; Emailin e datës 04.10.2022 nga për Emailin e datës 29.07.2022 nga për ankuesen; Emailin e datës 28.07.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 08.07.2022 nga për ankuesen; Procesverbalin e datës 04.10.2022; Vendimin me numër Ref: 211/2022 i datës 01.09.2022; Emailin e datës 10.02.2022 nga për Emailin e datës 02.07.2021 nga Vendimin me numër Ref: 177/2022 i datës 21.07.2022; Emailin e datës 02.09.2022 nga për Emailin e datës 01.12.2022 nga për Emailin e datës 02.09.2022 nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 14.02.2019 është e punësuar në pozitën "Zyrtare për Buxhet dhe Financa 2" në Ministrinë e Integritimit Evropian tani e fuzionuar në Zyrën e Kryeministrit, dhe rrjedhimisht meqenëse ende nuk është bërë ristrukturimi i Zyrës së Kryeministrit, ankuesja sipas emailit të datës 08.08.2022 të Shefit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm është caktuar që të punoj në Zyrën për Çështje të Komuniteteve në kudër të Zyrës së Kryeministrit.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, më datë 01.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Ref: 211/2022 për themelimin e



Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të parashtruar nga organizatat joqeveritare të cilët aplikojnë për mbështetje financiare që ofrohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në bazë të shpalljes publike të datës 06.07.2022 "*Financime i aktiviteteve që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të punësimit të pjesëtareve të komuniteteve jo shumicë*" (në tekstin e mëtejme Komisioni), i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin me numër Ref:212/2022 të datës 02.09.2022, me ç' rast në vend të B.Verbovci në cilësi të kryesues së këtij komisioni caktohet ankuesja.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër Ref:212/2022 të datës 02.09.2022, disa herë radhazi ka kërkuar që të largohet nga pozita e kryesuese se këtij komisioni, me arsyetimin së: "*e njëjta ka marr pjesë në Komisionin për zgjidhje të dy eksperteve të jashtëm sipas thirrjes publike të datës 06.07.2022, ende nuk ka përvetësuar detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Çështjet e Komuniteteve dhe se nuk përvojë në fushën e prokurimit*".

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm përmes shkresës (aktit) me numër Ref:263/2022 të datës 04.10.2022 ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "*Vërejtje*", për shkak të mos angazhimit dhe neglizhencën në kryerjen e detyrave siç janë përcaktuar me Vendimin për themelimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të parashtruar nga organizatat joqeveritare të cilët aplikojnë për mbështetje financiare që ofrohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së masa e kundërshtuar me ankesë është e pa bazë dhe tendencioze dhe së me shqiptimin e saj e njëjta është dëmtuar profesionalisht dhe personalisht.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, respektivisht kapitullin IV lidhur me Disiplinën në Shërbim Civil, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë të detajuar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndër lidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë",* andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë së ankuesja është duke i ushtruar detyrat dhe punët e Zyrtares në Zyrën për Çështje të Komuniteteve, Kolegji konstaton se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "*vërejtje*", sepse i njëjti nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses.

Sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm, kështu që nisur nga fakti së masa disiplinore e atakuar me ankesë është shqiptuar nga organi jo kompetent, Kolegji nuk u lëshua në konstatimin e ligshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Theksuar si më lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.954/2022**

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi dërgohet për:**

- Ankuesen
- Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësin e Zyrës së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit dhe;
- Arkivin e KPMSHCK-së.